

UNIVERSITETI I PRISHTINES

ABSTRAKT

PROGRAMI I STUDIMEVE : Fakulteti Juridik “PROGRAMI JURIDIKO – FINANCIAR”

KADIDATJA: Marigona Ismajli

MENTOR: Prof.Dr.Mejdi Bektashi

TITULLI I TEMËS: “POLITIKAT TREGTARE DHE ZBATIMI I TYRE: RASTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS”

Punimi i temës master me titull “POLITIKAT TREGTARE DHE ZBATIMI I TYRE: RASTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS” të kandidatës Marigona Ismajli është i hartuar në 91 faqe.

Punimi ndahet në 5 kapituj.

Kapitulli I:

1. Raporti në mes tregtisë dhe ekonomisë
2. Kuptimi, roli dhe zhvillimi i politikave tregtare
3. Instrumentet e politikës tregtare
4. Politika tregtare në Kosovë dhe sfidat e tashme

Në kapitullin e I-rë kryesisht përqendrohemi në rëndësinë e aplikimit dhe zhvillimit të politikave tregtare si dhe ndikimi i tyre në Republikën e Kosovës. Politikat tregtare i referohen rregulloreve dhe marrëveshjeve të ndryshme, të cilat njëkohësisht e rregullojnë eksportin dhe importin në një vend.

Kapitulli II:

1. Investimet e huaja direkte dhe Kosova
2. Llojet e investimeve të huaja (IHD)
3. Kriteret e ndarjes së investimeve të huaja
4. Teoria ekonomike e IHD
5. Investimet portfolio
6. Format e reja të investimeve
7. Faktorët që pengojnë tërheqjen e investimeve të huaja direkte
8. Fondi i investimeve

Ne kapitullin e II – të është dhënë një vështrim i përgjithshëm mbi përkufizimin e investimeve të huaja direkte si dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Po ashtu, gjatë këtij kapitulli përqendrohemi edhe në ndarjet dhe faktorët të cilët pengojnë tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve sistimore, Kosova siguron një mjedis mjaft të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktiviteteve ekonomike, siguron të drejta të barabarta për të gjithë investitorët, qofshin ata vendorë apo edhe të jashtëm. Prandaj, zbatimi i saktë i politikave tregtare, krijimi i kushteve të favorshme për investime, rritja e shkallës së eksportit, mbeten parimet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike

Kapitulli III:

1. Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA)
2. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)
3. Ruandi i Uruguai-t dhe Organizata Botërore e Tregtisë (OBT)
4. Sistemi i Përgjithësuar i Preferencave

Duke pasur parasysh se Kosova është pjesë e marrëveshjeve të ndryshme për tregti të lirë, qëllimi kryesor është krijimi i një zone të lirë tregtare. Prandaj, i gjithë hulumtimi në kapitullin e III-të përqendrohet në ndikimin e politikave tregtare, marrëveshjet e nënshkruara mes Kosovës dhe vendeve të tjera, rruga drejt anëtarësimit në mekanizma të fuqishëm ekonomiko-financiar si; Organizatën Botërore të Tregtisë, ndikimi i investimeve të huaja. Pra, në përgjithësi, të hulumtohen dhe analizohen hapat kryesorë drejt zhvillimit sa më të shpejtë ekonomik të Kosovës.

Kapitulli IV:

1. Bilanci tregtar i Kosovës
2. Damping-u dhe masat antidamping
3. Procedurat me Ndikim Ekonomik (PMNE)
4. Konkurrenca monopolitstike dhe tregtia
5. Tregtia Ndërkombëtare, një retrospektivë e Kosovës

Pasi që ekonomia e Kosovës është ekonomi e re dhe e orientuar në krijimin e kushteve potenciale për zhvillim duke i rritur kapacitetet e saj eksportuese, është me rëndësi të theksohet roli i institucioneve shtetërore në aplikimin e politikave tregtare. Tregtia e jashtme mbetet një ndër instrumentet kryesore dhe më të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Në këtë mënyrë, Kosova është e orientuar përkrah liberalizimit të tregtisë, ku duke parë zhvillimet e fundit, me rëndësi është edhe përfshirja e Kosovës në Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (GSP) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një program i cili është i dizajnuar për të nxitur rritjen ekonomike në vendet në zhvillim, duke ju ofruar trajtim preferencial për një numër të konsiderueshëm të mallrave.

Kapitulli V:

1. Korniza kohore e politikave zhvillimore të lidhura me tregtinë

2. Sektorët strategjikë në Kosovë
3. Identifikimi i barrierave tregtare
4. Shpërndarja e të ardhurave dhe politika tregtare

Gjatë kapitullit të V-të do të shtjellohen faktet lidhur me shtyllat kryesore të cilat kanë ndikim të veçantë në zhvillimin ekonomik të Kosovës, të cilat orientohen drejt liberalizimit të tregtisë janë: zëvendësimi i importit me produkte vendore, lehtësimet në treg si dhe promovimi i eksportit, përforcimi i marrëdhënieve mes institucioneve si dhe akterëve kryesorë të cilët forcojnë sektorin e tregtisë në Kosovë dhe në mënyrë direkte luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik.

Fjalet kyçe: Kosova, liberalizimi i tregtisë, investimet e huaja, barrierat tregtare.